

Aneksi 1

Perkufizime & Interpretime

Shqiperia	nenkupton Republikën e Shqiperise;
Barre Siguruese	Ka kuptimin e percaktuar nga ligji nr. Ligji Nr. 8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese" (i ndryshuar)
Kontrate	nenkupton kete Kontrate Konçesioni.
Ligji i zbatueshem	nenkupton çdo ligj te brendshem apo legjislacion dytesor (dekrete, vendime, urdhra apo udhezime ne nivel qendror apo vendor) te zbatueshem apo ligj ose rregullore tjeter te Republikes se Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim ne do kohe dhe kohe pas kohe gjate Periudhes se Konçesionit.
Dite pune	nenkupton nje dite gjate se ciles ne Republikën e Shqiperise punohet, me perjashtim te festave zyrtare dhe diteve te shtuna e te diela.
Ndryshim	nenkupton çdo ndryshim te kesaj Kontrate;
Proçedura e Kontrollit te Ndryshimit	nenkupton proçeduren per te ndryshuar kete Kontrate, sikurse eshte percaktuar ne Aneksin 6 (Proçedura e Kontrollit te Ndryshimit);
Kerkesa per Ndryshim	nenkupton nje kerkesa me shkrim per nje ndryshim te kontrates e cila do te jete thelbesisht ne formen e percaktuar ne Aneksin 6 (Proçedura e Kontrollit te Ndryshimit);
Konçesioni	Nenkupton dhenien nga Autoriteti te te drejtes se _____, nepermjet veprimtarive zbatuese sic parashikohet ne kete Kontrate;
Konçesioni	Nenkupton shoqerine: ".....shoqeri anonime, e regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. _____.

Shoqeria konçesionere	nenkupton shoqerine shqiptare te themeluar nga shoqeriaper zbatimin e Konçesionit ne perputhje me kete Kontrate;
Tarifa e Konçesionit	nenkupton shumen e pagueshme nga Konçesioneri ndaj Autoritetit Kontraktues per te drejtat dhe privilegjet e dhena ne kete Kontrate, ne shumet dhe menyren e percaktuar ne Nenin 13 (Tarifa e Konçesionit) te kesaj Kontrate;
Te Drejtat e Konçesionit	nenkupton te drejtat per te zbatuar Projektin;
Periudha e Konçesionit	Do te kete kuptimin qe i eshte dhene asaj ne Nenin 3.2.1 te kesaj Kontrate.
Personeli i Konçesionerit	nenkupton te gjithe punonjesit, agjentet, keshilltaret dhe kontraktoret e Konçesionerit
Informacioni Konfidencial	nenkupton çfaredo informacioni, sido qe te perçohet, qe ka lidhje me çeshtje biznesi, pune, zhvillime, sekrete tregtare, njohuri, personelin dhe furnitoret e seciles Pale si dhe çdo informacion tjetër qe eshte bere e qarte qe eshte konfidencial (pavaresisht nese atij i eshte vendosur shenja "konfidencial") ose qe do te konsiderohej pa dyshim si konfidencial;
Autoriteti	nenkupton Ministrine e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes te Republikes se Shqiperise.
Vit financiar te Kontrates	nenkupton nje periudhe prej 12 muajsh qe fillon ne Daten Efektive
Kontrolli	dhe rrjedhimet e tij do te nenkuptojne nese drejtperdrejt ose jodrejtperdrejt te drejtoje marrëdhëniet e dikujt tjetër me ane te pronesisë, kontrates ose menyra te tjera;
Plani i Korrigjimit	nenkupton vendimin e Konçesionarit per korrigjimin e çdo mosperputhje apo te çdo deshtimi tjetër ne realizimin e projektit ne perputhje me afatet dhe kushtet e kesaj Kontrateje;
Pazotesia	nenkupton çdo shkelje te detyrimeve te Pales perkatese (duke perfshire por jo e kufizuar ne shkeljet themelore apo shkeljet e afateve themelore) ose çdo pazotesi tjetër, akt, mungese, neglizhence ose qendrim te Pales perkatese, punonjesve te saj, nepunesve,

	agjenteve, ose nen-kontraktoreve ne lidhje me subjektin e kesaj Kontrateje dhe persa i perket pergjegjesise se seciles nga keto Pale ne lidhje me tjetren;
Vonesa	nenkupton periudhen e kohes ne te cilen zbatimi i sherbimeve, duke ju referuar Planit te Projektit, vonohet duke marre shkak nga nje deshtim per arritjen e nje Pikesymimi;
Konfliktet	nenkupton çdo konflikt, ndryshim ose çeshtje interpretimi qe del nga kjo Kontrate, duke perfshire çdo konflikt, ndryshim/ ose çeshtje interpretimi ne lidhje me Sherbimet, deshtim per te rene dakord ne perputhje me Proçedurat e Kontrollit te Ndryshimit ose çdo çeshtje ku kjo Kontrate i drejton Palet te zgjidhin çeshtje duke ju referuar Proçedures se Zgjidhjes se Konflikteve;
Proçedura e Zgjidhjes se Konflikteve	nenkupton proçeduren e zgjidhjes se konflikteve percaktuar ne Aneksin 10 (Proçedura e Zgjidhjes se Konflikteve);
Regjistri i Barreve Siguruese	Ka kuptimin e percaktuar nga ligji nr. Ligji Nr. 8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese"(i ndryshuar
Data Efektive	nenkupton daten ne te cilen kjo Kontrate nenshkruhet nga palet
Vit financiar	nenkupton nje periudhen qe fillon çdo vit me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetorin ne vijim;
Ngjarje	Akte rebelimi, trazire, sulme civile, greva të natyrës politike, akt ose fushatë terrorizmi ose sabotazh të një natyre politike që në çdo rast ndodhin brenda Republikës së Shqipërisë; Rrufe, zjarre, tërmet, stuhi, ciklon, tajfun, uragan ose fatkeqësi tjetër natyrore; Epidemi ose mortajë; dhe Greva ose ngjarje të ngjashme (përveçse nga punonjësit e Palës që e pretendon këtë si një Ngjarje Force Madhore ose të ndonjë Aksioneri të asaj Pale ose nga punonjësit e ndonjë filiali direkt ose indirekt, prind ose person të varur të ndonjë Aksioneri të asaj Pale); duke perfshire çdo konflikt me natyre industriale ne lidhje me Konçesionerin, Personelin e Konçesionerit apo çfaredo personel tjetër ne zinxhirin e furnizimit te Konçesionerit apo te Nen – kontraktorit.

Praktikat e Industrisë së Mirë	nenkupton ushtrimin deri në atë shkallë aftësie, kujdesi, përkujdesje, efektiviteti dhe kornizat kohore sikurse do të pritet nga një shoqëri drejtuese brenda industrisë përkatëse ose sektorit të biznesit;
Njohuritë	nenkupton të gjitha idetë, konceptet, skemat, informacionin, njohuritë, teknikat, metodologjitë, dhe çdo gjë tjetër në natyrën e njohurive që lidhet me Shërbimet por që përjashton njohuritë tashme në zotërimin të Konçesionerit ose të Autoritetit që përpara kësaj Kontrateje;
Pikesynimi	nenkupton një ngjarje ose detyrë të përkohshme në Planin e Projektit i cili, nëse është i zbatueshem, duhet plotësuar në datën përkatëse të pikesynimit;
Data e Pikesynimit	nenkupton datën e përcaktuar kundërt Pikesynimit përkatës në Planin e Projektit;
Muaji	nenkupton një muaj kalendarik dhe "Muajore" do të interpretohet në mënyrën e duhur;
Faza Opeacionale	faza në të cilën Konçesioneri do të vijojë të japë shërbimin e Regjistrimit të Barreve Siguruese sipas Sistemit të ri të ngritur prej tij
Sigurimi i Kontrates	nenkupton garancinë që duhet të jepet nga Konçesioneri në përputhje me Nenin 32 dhe Aneksin 11.
Plani i Projektit	nenkupton planin e përcaktuar me hollësi në Aneksin 8 (Plani i Projektit);
Te Ardhurat	nenkupton të ardhurat e gjeneruara të Konçesionerit nga Tarifat e Aplikimit;
Data e Rishikuar e Pikesynimit	nenkupton çdo datë të rishikuar e cila është përcaktuar për arritjen e një Pikesynimi;
Aneks	nenkupton një shtojcë ndaj kësaj Kontrate Konçesioni që formon një pjesë integrale të saj.
Deshtimi ose Mospërbushjes e detyrimeve	nenkupton një deshtim për të përbushur detyrimet e marra përsiper nga Konçesonari me këtë Kontratë;
Shërbimet/Detyrimet	nenkupton çdonjë dhe të gjitha (shërbimet që do të sigurohen)/detyrimet e marra përsiper nga

	Konçesionari bazuar ne kete Kontrate duke perfshire ato te percaktuara ne Aneksin 2 (Kerkesat e Autoritetit) dhe Aneksin 3 (Zgjidhja e Konçesionerit);
Kerkesat e autoritetit	nenkupton (pershkrimin e Sherbimeve te percaktuar) percaktimet e vendosura ne Aneksin 2 (Kerkesat e Autoritetit);
Ent shteteror	nenkupton cilendo ministri apo departament ose çfaredo autoriteti administrativ, civil apo ushtarak te Qeverise se Republikes se Shqiperise apo nenndarjet administrative te Qeverise se Shqiperise duke perfshire pa kufizim cilindo organ dhe cilendo shoqeri, organizate publike apo ent tjetere te zoteruar apo te kontrolluar drejtperdrejt apo ne menyre te terthorte nga, ose qe vepron per llogari apo perfitim te cilesdo apo cilavedo agjenci te Qeverise se Republikes se Shqiperise, duke perjashtuar ketu Autoritetin Kontraktues;
Njoftim Zgjidhjeje	nenkupton nje njoftim me shkrim te dhene ne perputhje me kete Kontrate, per te perfunduar kete Kontrate e cila do te parashtroje si minimum nje arsye per perfundimin;
Testet dhe Testimi	çdo testim qe kerkohet te behet bazuar ne kete Kontrate, sikurse eshte pershkruar me tej ne Aneksin 9 (Plani i Testimit);
Shkak i autoritetit	veprime ose mosveprime te Autoritetit te kryera me me dashje ose nga pakujdesia, qe kane sjelle pasoje mospermbushjen e detyrimeve te mara persiper me kete kontrate
Projekt	financimi, ngritja e Sistemit, operimi i Regjistrimit te Barreve Siguruese dhe transferimi i saj ne perfundim te afatit në pajtim me dhe sipas standardeve dhe normave të zbatueshme teknike dhe me këtë Kontrate.
Sistemi	nënkupton sistemin hardware dhe software te ngritur nga Konçesionari per vijimin e dhenis se sherbimit te Regjistrimit te Barreve Siguruese .

Aneksi 2

Kerkesat e Autoritetit

Dokumentat e Procedures konkurruese

1. Formulari i Ofertes
2. Udhezim per kandidatet/ Ofertuesit
3. Kriteret e Pergjithshme te kualifikimit/ pjesmarrjes
4. Formulari i sigurimit te ofertes
5. Formulari i sigurimit te kontrates
6. Formulari i njoftimit te fituesit
7. Njoftim standart per ofertuesin e skualifikuar
8. Formulari i ankeses per proceduren konkurruese
9. Formular i publikimit te njoftimit te kontrates fituese
10. Kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te kontrates koncesionare
11. Njoftimi i kontrates

Aneksi 3

Oferta e Koncesionarit

Date: 12.03.2009

Ref: Procedura konkurruese: Dhenia me Koncesion e Shërbimit të Regjistrit të Barreve Siguruese”

Drejtuar: Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes

Shoqeria “ROEN Company” sh.p.k. paraqet oferten e meposhtme:

Nr.	Kriteret	Njesia e Matjes	OFERTA
1.	Vleresimi Teknik a) Cilesia e pajisjeve Hardware dhe Cilesia e Software b) Cilesia e infrastruktures fizike qe mbeshtet sherbimin c) Metodologjia e kryerjes se transaksioneve me regjistrim		
2.	Vlera e Investimit a) Investimi Total b) Vlera e Investimit ne teknologji e pajisje	LEK	35 961 880 5 791 880
3.	Vlera e “Fee koncesionare” e shprehur ne % te te ardhurave vjetore	%	2%
4.	Vlera e ri-investimit e shprehur ne % te investimit	%	20%

Ne kontratat me objekte te ndryshme sipermarrese te shprehura ne EURO eshte marre kursi i shkembimit 1 € = 130 Lek.

Per ROEN Company” sh.p.k.

Znj. Brumilda Jegeni
Administratore
ROEN Company
Blv. “Zogu I”, Pallati prane FSHN
Kati II, Zyra Nr. 2, Tirane
Tel: 04 2264675
Fax: 04 2264677
e-mail: bjegeni@roen.com

Aneksi 4

Çeshtje financiare

I. Penalitetet e Zbatueshme ne Rast Vonese

Konçisioneri do t'i paguaje Autoritetit Pagesat e Vonese, si vijon:

1. Themelimi i shoqerise se re koncesionare per zbatimin e projektit

Konçisioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Konçisioneri deshton ne themelimin e shoqerise se re koncesionare, (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

500 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 2000 Euro.

Pas javes se peste te voneses, Autoriteti mund te kerkoje zgjidhjen e Kontrates. .

2. Implementimin e rrjetit kompjuterit (hardware), implementim i sistemit te ri Software si dhe arredimi i zyrave te reja te sherbimit te Regjistrit te Barreve Siguruese,

Konçisioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Konçisioneri deshton ne permbushjen e kerkesave te sipercituara (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

500 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 2000 Euro.

Pas javes se peste te voneses, Autoriteti mund te kerkoje zgjidhjen e Kontrates. .

3. Prezantimi i planit te testimiit (hardware dhe Software)

Konçesioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Konçesioneri deshton ne paraqitjen e Planit te Testimit, (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e Pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

500 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 2000 Euro.

4. Akomodimi i stafit ne zyrate e reja te sherbimit te Regjistrit te Barreve Siguruese dhe vijimi i dhenies se sherbimit sipas sistemit te ri te ngritur.

Konçesioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Konçesioneri deshton ne akomodimin e stafit dhe vijimin e dhenies se sherbimit sipas Sistemit te ri (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

500 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

500 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 2000 Euro.

Pas javes se peste te voneses, Autoriteti mund te kerkoje zgjidhjen e Kontrates. .

5. Prezantimi i Planit te Rimekembjes nga Dertimet e Renda

Konçesioni do t'i paguajë Autoritetit një penaltë si vijon për çdo javë të plotë në të cilën Konçesioni deshton në prezantimin e Planit të Rimekembjes (siç përcaktohet në Anëksin 8):

Javë e parë është periudhë falje e si rrjedhim:

500 Euro në javë për javën (tjetër) e parë vonese pas Javës së Parë

500 Euro në javë për javën e dytë vonese pas Javës së Parë

500 Euro në javë për javën e tretë vonese pas Javës së Parë

500 Euro në javë për javën e katërt vonese pas Javës së Parë

Shuma maksimale e penalteteve për këto vonesa do të jetë në total 2000 Euro

6. Penaltet e zbatueshme për vonesa në pagimin e tarifës së koncesionit

Për çdo ditë vonese të pagesës së Fee Koncesionare paguhet një kamat vonese prej 0,1% (në ditë) të vlerës së detyrimit për vitin përkatës.

III. Per moskryerje te vleres se investimeve dhe riinvestimeve te pranuar ne oferte

Për moskryerje të investimeve në vlerën e marrë përsiper në konkurim, koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës të investimeve dhe riinvestimeve të përfunduara.

Aneksi 5:

VERTETIM DHENIE NE DOREZIM

Grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të Autoritetit dhe përfaqësuesi i Koncesionarit, në zbatim të Kontrates së Koncesionit “_____” datë ____ 2009, të nënshkruar ndërmjet Autoritetit dhe Koncesionarit, ky i fundit bie dakord dhe pranon nga Autoriteti sa më poshtë:

1. Zyrat eksistuese

- a- Vendndodhja e sipërfaqes që do të jepet Koncesionarit në dorezim është
- b- Sip _____ m²
- c- etj

2. Gjendja e objektit

3. Pajisjet eksistuese

4. Gjendja e pajisjeve eksistuese

Koncesionari bie dakord dhe pranon dorezimin e objektit sipas përshkrimit të mësipërm.

Zbatuar në _____ Republikën e Shqipërisë me _____.

Përfaqëson dhe vepron në emër të Autoritetit

(Emri)

(Pozicioni)

Përfaqëson dhe vepron në emër të Koncesionarit

(Emri)

(Pozicioni)

Aneksi 6:

Procedura e Ndryshimeve te Kontrates



1. Parime te Pergjithshme

Ky Aneks (Procedura e Ndryshimeve te Kontrates) percakton proceduren per trajtimin e Ndryshimeve te Kontrates.

Pa paragjykuar asnje nga dispozitat e kesaj Kontrate, te dy palet:

- (a) pranojne nevojen per te vepruar ne menyre te arsyeshme ne te gjitha rastet lidhur me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve te Kontrates; dhe
- (b) marrin persiper te veprojne ne menyre te arsyeshme ne lidhje me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve te Kontrates.

2. Kerkesa per Ndryshim

Secila pale mund t'i beje nje Kerkese per Ndryshim pales tjetere ne çdo kohe gjate Kohezgjatjes se Kontrates.

3. Autorizimi i Ndryshimit

Asnje Ndryshim Kontrate i perpunuar sipas ketij Aneksi nuk do te autorizohet dhe Koncesionari nuk do te zbatoje asnje Ndryshim Kontrate pa u miratuar dhe nenshkruar nga Autoriteti.

Dokumenti i Autorizimit te Ndryshimit

Nr.	Titulli	Data e paraqitjes:	Paraqitur nga:
Projekti	Kerkuar deri me daten		
Detaje te kerkesave te lidhura me Ndryshimin e Kontrates dhe me Dokumentet e Autorizimit te Ndryshimit			
Perskrim i hollesishem i Ndryshimit te Kontrates			
Afatet e parashikuara kohore			

Detaje lidhur me fazat dhe me grafikun e zbatimit
Detaje te varesive te tjera (duke perfshire çdo kontribut te kerkuar nga Pala kerkuese)
Detaje te produkteve rezultuese per dorezim
Detaje te detyrimeve shtese individuale dhe te mjeteve per percaktimin e tyre (per shembull, ne baze çmimi fiks ose kostoje shtese)

Autorizimi i Ndryshimit te Kontrates (Po/Jo)		
Autorizim :		
	Firma:	Data:
	Firma:	Data:
Detaje shtese lidhur me vendimin (nese kerkohen)		
Kerkese per Pune/Numri i Kuotes	Numri i Urdhrit	Konfirmimi i Realizimit

Aneks 7:

CERTIFIKATA E PRANIMIT TE DOREZIMIT

Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes se Shqiperise ("Autoriteti") ne perputhje me Kontraten e Koncesionit te nenshkruar rregullisht, ndermjet Autoritetit dhe Koncesionarit me ___/___/2009, bie dakord dhe pranon kalimin nga Koncesionari tek Autoriteti te objekteve te meposhtme te Koncesionit:

OBJEKTET E KONCESIONIT	SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE PERSHKRIMI
	[Te dhena nga Koncesionari]
(a)	
(b)	
(c)	
(d)	
(e) Komponente te Tjere	
Etj.	
OBJEKTE TE TJERA (dokumente, manuale)	

1. Asetet e mesiperme, kalohen nga Koncesionari tek Autoriteti ne perputhje me termat dhe kushtet e Kontrates.
2. Autoriteti miraton dhe pranon objektet e mesiperme te Koncesionit nga Koncesionari tek Autoriteti ne perputhje me termat dhe dispozitat e Kontrates.

Zbatuar ne [_____], me _____.

Perfaqeson dhe vepron ne emer te Autoritetit

(Emri): _____

(Pozicioni): _____

Perfaqeson dhe vepron ne emer te Koncesionarit

(Emri): _____

(Pozicioni): _____

Aneksi 8

Plani i Projektit

Pikesynimet kryesore të Koncesionit janë:

	Pikesynimet	Data e Pikesynimit
1	<u>Thehërimi i shogërisë së koncesionare për zbatimin e projektit</u>	Data Efektive + 30 dite (T1)
2	<u>Implementimin e rrejtë kompjuterit (hardware) dhe implementim i sistemit të ri software si dhe arredimi i zyrave të reja të shërbimit të Regjistrimit të Barreve Siguruese,</u>	Data Efektive + 30 dite (T2)
3	<u>Prezantimi i planit të testimit (hardware dhe software)</u>	Data Efektive + 60 dite (T3)
4.	<u>Akomodimi i stafit në zyrave të reja të shërbimit të Regjistrimit të Barreve Siguruese dhe vijimi i dhënies së shërbimit sipas sistemit të ri të ngritur.</u>	T3 + 30 dite (T4)
5.	<u>Prezantimi i Planit të Rimëkembjes nga Dëmtimet e Renda</u>	Data efektive + 4 muaj (T5)

Aneksi 9

Plani i Testimit

1. Hyrje

Perpara testimit te Sistemit (hardware dhe software) Konçesionari do te dergoje prane Autoritetit nje plan te testimit me qellim qe te verifikoje perputhshmerine e sistemit te vendosur me percaktimet e hollesishme te tij siç percaktohet ne Aneksin 2 dhe 3.

Konçesioneri do t'i siguroje Autoritetit per miratim Planin e Testimit, siç percaktohet ne paragrafin e mesiperm.

2. Organizimi i Testit te Pranimit

Kur projekti te jete implementuar dhe te jete gati per zbatim dhe pasi ka njoftuar Autoritetin, Koncesionari do te organizoje testimin e pranimit i cili do te konsistoje ne:

- Regjistrimin e formulareve apo transakcioneve te kerkuara nga subjektet e ndryshme ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe rregulloreve "Per Barret Siguruese" (pasi eshte vleresuar me pare dokumentacioni nga juristi). Sistemi i softit te jete ne gjendje te beje nje regjistrim te sakte te barreve siguruese dhe te procedoje korrektesisht te gjithë transakcionet qe permban njoftimi B (formulari i regjistrimit);
- Kerkim te sakte te informacionit nga baza e te dhenave te regjistrimit per barret siguruese apo transakcionet e regjistruara kohe me pare. Sistemi duhet te ruaje dhe zbuloje informacionin ne baze te kriterëve te kerkimit sipas legjislacionit perkates. Sistemi nuk duhet te shfaqe ne rezultatin e kerkimit informacion mbi nje regjistrim qe ka perfunduar ose eshte fshire;
- Paraqitje te sakte e tarifave nga sistemi e te gjitha tarifave te transakcioneve qe kryen regjistrimi;
- Administrimin e informacionit ne menyre bashkekohore.

Aneksi 10

Procedura e Zgjidhjes se Mosmarrveshjeve

Permbajtja

1. Hyrje/Historik
2. Shkallet
3. Zgjidhja Alternative e Mosmarrveshjeve
4. Percaktimi i Eksperteve
5. Performanca e vazhdueshme




1. Hyrje

1.1 Çdo mosmarreveshje do te zgjidhet ne perputhje me Proceduren e Zgjidhjes se Mosmarreveshjeve te percaktuar ne kete Aneks.

2. Shkallet

- 2.1 Nese ndermjet Autoritetit dhe Koncesionarit do te linde ndonje çeshtje qe perben shqetesim, atehere Palet do te bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per ta zgjidhur nje çeshtje te tille ne menyre sa me te shpejte dhe praktike qe te jete e mundshme, ne ate nivel qe nje mosmarreveshje e tille do te krijohet. Minimalisht, palet do te sigurojne se e kane diskutuar çeshtjen ne driten e fakteve qe lidhen me çeshtjen, qe e kane kaluar ate neper nivelet operative, menaxheriale dhe ekzekutive te shqyrtimit (sipas mundesise) dhe se kane bere te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te arritur ne nje zgjidhje.
- 2.2 Sipas Paragrafit 4 te ketij Aneksi, kur Palet nuk arrijne nje zgjidhje per mosmarreveshjen, ato do te perpiqen t'i zgjidhin ne funksion te pershkallezimit te mosmarreveshjes, duke perdorur Procesin e Shkallezimit te percaktuar ne kete Aneks, perpara nisjes se nje procedure alternative te zgjidhjes se mosmarreveshjes nepermjet emerimit te nje eksperti apo grupi ekspertesh.
- 2.3 Ku lind nje çeshtje, e cila nuk mund te zgjidhet ne ate nivel qe kjo çeshtje lind, atehere Autoriteti ose Koncesionari mund ta dergojne ate prane nivelit tjetër ne procesin e Shkallezimit.
- 2.4 Procesi i Shkallezimit synon te jete nje udhezues per palet lidhur me zgjidhjen e çeshtjeve ne menyre po aq te shpejte sa ato lindin. Synimi nuk eshte qe Procesi i Shkallezimit te funksionojë ne menyre jo fleksibel apo ne nje menyre te tille qe pengojë zgjidhjen e nje çeshtje ne nivelin me te pershtatshem dhe sa me shpejt qe te jete e mundur.
- 2.5 Kur, ne çdo nivel, vendoset qe çeshtja ka kaluar neper shkalle sipas menyres se duhur, Palet do te bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per ta zgjidhur çeshtjen.
- 2.6 Kur pranohet nje zgjidhje, vendimi se bashku me planin e zbatimit do te raportohen me shkrim.
- 2.7 Kur nje çeshtje nuk mund te zgjidhet ne nje nivel, atehere ajo do te kalohet ne nivelin tjetër me te larte ne perputhje me Paragrafin 2.4 me siper.

2.8 Pervec rastit kur nje ceshtje kerkon zgjidhje te shpejte, ku veprimet e Autoritetit jane ose mund te ndikohen negativisht ose kur secila Pale mund te pesoje kosto domethenese si rezultat i moszgjidhjes se ceshtjes, referimi i ceshtjes do te behet me raport te shkruar per tek niveli tjetër nga Pala e cila referon ceshtjen. Raporti do te permbaje, te pakten informacionin e meposhtem:



- Emrin dhe adresen e iniciatorit;
- Data kur eshte ngritur ceshtja per here te pare;
- Pershkrimi i ceshtjes, duke perfshire çdo histori me probleme te ngjashme;
- Implikimet ceshtjes, seriozitetin e saj dhe shkallen e urgjences qe kerkohet;
- Nje vleresim te kostos aktual dhe potenciale te ceshtjes; dhe
- Emrat dhe adresat e te tjereve te perfshire, te cilet mund te kete nevojë te konsultohen.

2.9 Brenda 5 (pese) dite pune nga marrja e vendimit per shkallezimin, iniciatori dhe homologu i tij do te pergatisin dhe pranojne nje raport per nivelin tjetër dhe homologut do t'i jepet nje kopje e raportit. Kur raporti nuk mund te pranohet, atehere çdo verejtje shtese qe mund te kerkoje Pala tjetër, do t'i bashkelidhet raportit.

2.10 Sapo raporti te jete dorezuar, personat perkates te nivelit te dhene do te kontaktoje me njeri-tjetrin sa me shpejt qe te jete e mundur per te zgjidhur ceshtjen qe eshte subjekt i referimit brenda nje periudhe shtese prej 5 (pese) ditesh pune pas se ciles, ceshtja do te referohet ne nivelin pasardhes ose, do te zbatohen, ne vijim te referimit te nivelit 4, procedurat e percaktuara ne paragrafet 3, 4 dhe 5.

Nivelet e shkallezimit jane si me poshte vijon:

Niveli	Autoriteti	Koncesionari
Niveli 1	Perfaqesuesi i Autoritetit	Menaxheri i Pergjithshem i Kompanise Koncesionare
Niveli 2	Zevendes Ministri	Drejtori i Pergjithshem i Projektit
Niveli 3	Ministri i METE	Asambleja e Pergjithshme e shoqerise koncesionare

3. Percaktimi i Ekspertit

Nëse një mosmarrëveshje në lidhje me një çështje teknike nuk mund të zgjidhet me anë të Procesit të Shkallëzimit, atëherë mosmarrëveshja mundet, sipas një marrëveshjeje ndërmjet paleve, t'i referohet një eksperti (Eksperti) për një percaktim përfundimtar, i cili do të konsiderohet se vepron si ekspert dhe jo si arbiter; dhe

3.1 Eksperti do të zgjidhet me marrëveshje reciproke.

3.2 14 (katërmbëdhjetë) ditë pasi Eksperti ka pranuar emërimin, palet do të dorëzojnë një raport të shkruar lidhur me mosmarrëveshjen pranë Ekspertit dhe pranë njeri-tjetrit dhe 7 (shtatë) ditë më pas do të dorëzojnë me shkrim çdo koment që ata dëshirojnë t'i bëjnë Ekspertit ose njeri-tjetrit.

3.3 Më pas, të dy palet do t'i sigurojnë Ekspertit të gjithë asistencën e nevojshme që do të kërkojë për të shqyrtuar mosmarrëveshjen duke përfshirë, dhe jo vetëm, aksesin e plote tek Sistemi dhe çdo dokumentacion apo korrespondencë që ka të bëjë me sistemin.

3.4 Eksperti do të udhëzohet për të dhënë percaktimin e tij për palet brenda 14 ditësh pas dorëzimit të raporteve me shkrim në zbatim të Paragrafit 3.3.


3.5 Vendimi i Ekspertit do të jetë i formës së prirë dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të apelojë.

3.6 Tarifat për Ekspertin do të perballohen nga palet sipas raportit që do të percaktohet nga Eksperti duke marrë parasysh (nder të tjera) sjelljen e paleve.

4. Performanca e Vazhdueshme

4.1 Autoriteti dhe Koncesionari do të vazhdojnë përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate në prirje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, me kusht që asgjë që përmban ky Aneks nuk pengon apo kufizon Palet në lidhje me ushtrimin e ligjshëm të së drejtave të tyre sipas nenit 40 të Kontrates, në çdo kohë.

Aneksi 11



**FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES
GARANCI BANKARE / SHOQERI SIGURIMI**

Data ___ __ 2009

Per:

Emri i Autoritetit kontraktues
Adresa e Autoritetit kontraktues

Duke gene se (*emri i kontraktuesit*) ka marre persiper ne baze te Kontrates Nr. date te realizoje (*emertimi dhe pershkrim i shkurter i objektit te kontrates*):

Duke gene se ne Kontraten tuaj kerkohet *Garanci Bankare/ Sigurimi* ne shumen e specifikuar ne te, si sigurim per permbushjen e detyrimeve te parashikuara ne kontrate :

Duke gene se (*emri dhe adresa e Bankes/Shoqerise se Sigurimit*) eshte dakord te leshoje kete garanci :

Deklarojme se ne jemi garantuesit e kontrates se mesiperme deri ne shumen totale prej (*shuma ne shifer dhe fjale*), shume e cila eshte e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate. Ne marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej (*shuma e garancise*).

Me kete garanci ju sigurojme se nuk eshte nevoja t'i drejtoheni me pare Kontraktuesit per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj.

Deklarojme gjithashtu, se asnje shtese apo ndryshim i kushteve te kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me kontraktuesin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin 30 dite pas perfundimit te afatit te kontrates.

Nenshkrimi dhe Vula e Bankes/Shoqerise se Sigurimit